



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 21

2003

Mars

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9017 datë 6.3.2003	Për një ndryshim në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.....	641
Ligj nr.9018 datë 6.3.2003	Për mbledhjen e armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake.....	642
Ligj nr.9019 datë 6.3.2003	Për ratifikimin e “Protokollit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për zhvillimin e programeve të mbështetjes së forcave të policisë shqiptare dhe të bashkëpunimit ndërmjet të dyja vendeve në luftë kundër kriminalitetit, nëpërmjet zyrës ndërlidhëse italiane në Shqipëri dhe oficerit ose oficerëve shqiptarë të kontaktit në Itali”.....	645
Ligj nr.9020 datë 6.3.2003	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për etiketimin e eksplozivëve plastikë për qëllime zbulimi”.....	649

Vendim i Kuvendit nr.68, datë 20.2.2003	Për mënyrën e trajtimit të deputetëve.....	656
Vendim i Kuvendit nr.70, datë 10.3.2003	Për ngritjen e komisionit hetimor të kuvendit për shqyrtimin e ligjshmërisë së përdorimit të fondeve publike dhe të ardhurave të tjera në Ministrinë e Kulturës dhe Bashkinë e Tiranës për periudhën 1992-2002, si dhe zbatimin e ligjshmërisë për zhvillimin urbanistik në Tiranë për periudhën 1992-2002.....	657
Vendim i Kuvendit nr.71, datë 13.3.2003	Për miratimin e përbërjes së Komisionit hetimor të Kuvendit, ngritur me vendimin e Kuvendit nr.70, datë 10.3.2003.....	658
Vendim i Kuvendit nr.72, datë 17.3.2003	Për ngritjen e Komisionit hetimor të Kuvendit për hetimin e veprimtarisë së qeverisë për transparencën e procesit të firmave piramidale në bazë të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”.....	659
Vendim i Kuvendit nr.73, datë 20.3.2003	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr.37, datë 16.5.2002 “Për krijimin e Komisionit të Integritetit Europian dhe Paktit të Stabilitetit”, i ndryshuar.....	659

L I G J
Nr.9017, datë 6.3.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7895, DATË 27.1.1995
“KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pas nenit 334 shtohet neni 334/1 si më poshtë:

“Neni 334/1

“Pavarësisht nga neni 278, përjashtohen nga ndjekja penale për armëmbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake personat që në përputhje me legjislacionin në fuqi, dorëzojnë vullnetarisht armët deri më datën 31.5.2005.

Në çdo rast nuk përjashtohen nga ndjekja penale për armëmbajtje pa leje personat që kanë kryer vepër penale, duke përdorur si mjet për këtë qëllim armë dhe municione luftarake.

Nuk përjashtohen nga ndjekja penale edhe personat të cilët, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, deklarojnë se nuk kanë armë e municione luftarake dhe nga kontrollet e ushtruara në mbështetje të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale u gjenden armë e municione të fshehura.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3750, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9018, datë 6.3.2003

PËR MBLEDHJEN E ARMËVE, TË MUNICIONEVE DHE MATERIALEVE
TË TJERA LUFTARAKE

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj ka si objekt dorëzimin vullnetar, regjistrimin dhe mbledhjen e armëve, municioneve dhe materialeve të tjera luftarake, që mbahen pa leje, si dhe masat shtrënguese që merren për zbatimin e tij.

Neni 2

Parimet e procesit të mbledhjes së armëve

Procesi i mbledhjes së armëve bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe synon, në bashkëpunim me shoqërinë civile, donatorët dhe me organizmat ndërkombëtarë, sensibilizimin e opinionit për krijimin e një shoqërie pa armë dhe dhunë.

KREU II

STRUKTURAT SHTETËRORE PËR MBLEDHJEN E ARMËVE DHE DETYRAT

Neni 3

Komisioni ndërministror i mbledhjes së armëve

1. Për të realizuar procesin e mbledhjes së armëve në Republikën e Shqipërisë krijohet komisioni ndërministror i mbledhjes së armëve me këtë përbërje:

- Zëvendëskryeministri- Kryetar
- Ministri i Rendit Publik - Zëvendëskryetar
- Ministri i Drejtësisë- anëtar
- Ministri i Mbrojtjes- anëtar
- Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit - anëtar
- Kryetari i SHISH-it- anëtar

2. Ministria e Rendit Publik ngarkohet me detyrën e sekretariatit të komisionit ndërministror të mbledhjes së armëve dhe i jep këtij komisioni të gjithë mbështetjen infrastrukturore dhe profesionale. Komisioni ndërministror i mbledhjes së armëve mund të kërkojë ndihmë edhe nga specialistë të ministrive të tjera të paparashikuara në këtë ligj.

Neni 4

Detyrat e komisionit ndërministror të mbledhjes së armëve

1. Komisioni ndërministror i mbledhjes së armëve ndjek në vazhdimësi procesin e mbledhjes së armëve, bazuar në të dhënat e sjella nga Ministri i Rendit Publik, Ministri i Mbrojtjes e Prokurori i Përgjithshëm dhe, jo më pak se një herë në tre muaj, analizon punën e bërë dhe raporton me shkrim përpara Këshillit të Ministrave.

2. Komisioni ndërministror i mbledhjes së armëve, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, strukturat e Forcave të Armatosura, organizatat jofitimprurëse dhe ato ndërkombëtare organizon fushata mbarëkombëtare dhe vendore për sensibilizimin publik ose veprimtari të tjera për dorëzimin vullnetar të armëve, municioneve dhe materialeve të tjera luftarake.

3. Komisioni merr vendime për mbarëvajtjen e procesit të mbledhjes së armëve nga strukturat e njohura me këtë ligj.

Neni 5

Komisionet e qarqeve për mbledhjen e armëve dhe detyrat e tyre

Pranë çdo qarku krijohet komisioni i qarkut për mbledhjen e armëve me këtë përbërje:

- prefektikryetar

- kryetari i këshillit të qarkut zëvendëskryetar
- drejtori i policisë së qarkut anëtar
- komandantët e njësisë ushtarake anëtarë.

2. Komisioni i qarkut ndjek në vazhdimësi procesin e mbledhjes së armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake dhe, jo më pak se një herë në muaj, raporton pranë komisionit ndërmënytor të mbledhjes së armëve.

3. Komisioni i qarkut bashkëpunon me të gjitha organizmat ndërkombëtarë ose shoqërinë civile, të përfshira në procesin e mbledhjes së armëve, të autorizuar nga komisioni ndërmënytor i mbledhjes së armëve.

4. Komisioni i qarkut, në bashkëpunim me komisionet vendore dhe policinë, përcakton grafikun e shkeljes së terrenit nga struktura e policisë së mbledhjes së armëve.

Neni 6

Komisionet vendore të mbledhjes së armëve

1. Komisionet e qarqeve të mbledhjes së armëve, nisur nga shtrirja dhe problemet që duhet të përballojnë në procesin e mbledhjes së armëve, krijojnë komisionet vendore të mbledhjes së armëve pranë rretheve, bashkive dhe komunave, nën juridiksionin e qarkut që mbulohet prej tyre.

2. Komisionet vendore bashkëpunojnë me të gjithë organizmat ndërkombëtarë ose shoqërinë civile, të përfshirë në procesin e mbledhjes së armëve, të autorizuar nga komisioni ndërmënytor i mbledhjes së armëve.

Neni 7

Struktura e policisë së mbledhjes së armëve

1. Për mbledhjen e armëve krijohen, në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit në Ministrinë e Rendit Publik, strukturat e policisë së mbledhjes së armëve.

2. Ministri i Rendit Publik miraton strukturat për mbledhjen dhe regjistrimin e armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake, sipas niveleve të organizimit të Policisë së Shtetit. Limiti i numrit të punonjëseve të këtyre strukturave miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Struktura e policisë së mbledhjes së armëve është pjesë përbërëse e Policisë së Shtetit dhe gëzon të gjitha të drejtat e detyrimit që rrjedhin nga ligji nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".

4. Kjo strukturë ka detyrë mbledhjen e armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake, që dorëzohen vullnetarisht, si dhe regjistrimin e tyre.

5. Për mbledhjen e armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake, struktura e policisë së mbledhjes të armëve bashkëpunon edhe me sektorë të tjerë të Policisë së Shtetit, pavarësisht nga funksionimi i kësaj strukture.

KREU III

DORËZIMI VULLNETAR

Neni 8

Dorëzimi vullnetar

1. Me dorëzim vullnetar të armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake kuptohet shprehja e vullnetit të lirë me shkrim dhe dorëzimi në organet e policisë vendore ose organet e pushtetit vendor të armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake, që mbahen pa leje.

2. Struktura e policisë së mbledhjes së armëve, me marrjen e të dhënave për vendndodhjen e armëve, i tërheq ato në bazë të procedurave përkatëse.

3. Personi që shpreh vullnetin për ta dorëzuar armën dhe dëshiron anonimatin, e dorëzon atë në vende publike, të ngritura nga policia, pa bërë deklarinimin përkatës.

Neni 9
Bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes

Ministria e Rendit Publik dorëzon armët, municionet dhe materialet e tjera luftarake, të mbledhura nga Policia e Shtetit, së bashku me dokumentacionin përkatës, në njësitë ushtarake të përcaktuara më parë nga Ministria e Mbrojtjes.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10
Hartimi i strategjisë kombëtare për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta

Komisioni ndërministror i mbledhjes së armëve, në bashkëpunim me të gjitha organet shtetërore, që bëjnë pjesë në këtë komision, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, harton strategjinë kombëtare për kontrollin e armëve të vogla e të lehta, e cila shqyrtohet dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 11
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të neneve 7 e 10 të këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore dhe, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të caktojë fondet e nevojshme për përballimin e shpenzimeve që lindin nga zbatimi i këtij ligji.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3763, datë 27.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9019, datë 6.3.2003

**PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË PËR
ZHVILLIMIN E PROGRAMEVE TË MBËSHTETJES SË FORCAVE TË POLICISË
SHQIPTARE DHE TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET TË DYJA VENDEVE NË LUFTË
KUNDËR KRIMINALITETIT, NËPËRMJET ZYRËS NDËRLIDHËSE ITALIANE NË
SHQIPËRI DHE OFICERIT OSE OFICERËVE SHQIPTARË TË KONTAKTIT NË ITALI”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli i mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe

Qeverisë së Republikës të Italisë për zhvillimin e programeve të mbështetjes së forcave të Policisë Shqiptare dhe të bashkëpunimit ndërmjet të dyja vendeve në luftë kundër kriminalitetit, nëpërmjet zyrës ndërlidhëse italiane në Shqipëri dhe oficerit ose oficerëve shqiptarë të kontaktit në Itali”, nënshkruar në Leçe (Itali) më 11 nëntor 2002.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3757, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

PROTOKOLLI I MIRËKUPTIMIT

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE

Lidhur me zhvillimin e programeve të mbështetjes së forcave të policisë shqiptare dhe bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në luftë kundër kriminalitetit nëpërmjet zyrës ndërlidhëse italiane në Shqipëri dhe oficerit (oficerëve) shqiptar(Ë) i (të) kontaktit në Itali

Duke u bazuar në Marrëveshjen në fuqi midis Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës Italiane në fushën e luftës kundër trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe të kriminalitetit të organizuar, firmosur në Tiranë, më 24 gusht 1991;

- duke u mbështetur në protokollin shtesë firmosur në Tiranë, më 24 gusht 1991 nga Ministri e Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe të Brendshëm të Republikës Italiane dhe në integrim të marrëveshjes së mëparshme;

- duke marrë parasysh procesverbalin e mbledhjes së parë të komitetit bilateral shqiptaro-italian, sipas Marrëveshjes së 24 gushtit 1991, që u zhvillua në Tiranë, më 9 dhjetor 1996;

- duke konsideruar protokollet dypalëshe të mirëkuptimit të viteve 1997, 1998, 2000, 2001;

- duke vlerësuar rezultatet e arritura nga misioni italian interforcë në veprimtarinë e këshillimit, trajnimit dhe asistencës në favor të forcave të policisë shqiptare, si dhe nga zyra ndërlidhëse italiane interforcë, në bashkëpunim me policinë shqiptare, në luftën kundër kriminalitetit, si dhe të nismave të ndërmarra nga Ministria Shqiptare e Rendit Publik për përmirësimin e profileve organizuese dhe operative të Policisë së Shtetit Shqiptar;

- duke konfirmuar interesin e përbashkët në forcimin e mirëkuptimit për ta bërë më efektive dhe sistematike luftën kundër krimit të organizuar dhe parandalimin e flukseve emigruese klandestine, si dhe të trafikëve të tjera midis Shqipërisë dhe Italisë;

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Italiane, që prej këtij do të quhen Palë,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Pala italiane, në lidhje me nevojat e realizimit të programeve të parashikuara në protokollet e mëparshme të mirëkuptimit, ofron, ku të jetë e nevojshme dhe me kërkesë të Palës shqiptare, mbështetje të mëtejshme forcave të policisë shqiptare, në përfshirje të veprimtarisë së këshillimit dhe trajnimit të kryer deri tani.

Neni 2

Për të siguruar një luftë më efektive kundër fluksit emigrues klandestin dhe të trafikëve të tjera të paligjshme, nëpërmjet mjeteve detare të përmirësuara për kontrollin e brigjeve shqiptare, Policia Kufitare Shqiptare, duke përdorur edhe mjetet lundruese të dhuruara nga pala italiane për të rritur kapacitetin operativ, garanton patrullimin e të gjithë bregdetar, me asistencën e mjeteve

lundruese të forcave të policisë italiane, deri më 31.12.2003.

Do të përsosen marrëveshje të nivelit tekniko-operativ, për përfshirjet e nevojshme në veprimtaritë e luftës kundër fenomeneve të lartpërmendura përgjatë brigjeve me ato që kryhen nga Policia Kufitare Shqiptare në territorin e saj.

Pala shqiptare do t'i përmbahet nismave që kanë për qëllim lehtësimin e koordinimit të veprimtarive të specifikuara në pikat e mësipërme, si dhe ato që parashikohen nga marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe në lidhje me kontrollin e kufijve të saj tokësorë dhe detarë.

Mbetet i konfirmuar angazhimi, sipas mënyrave të parashikuara në nivel teknik, të mjeteve ajrore të forcave të policisë italiane në mbështetje të veprimtarisë së policisë shqiptare në operacionet e parandalimit të përgjithshëm dhe të luftës kundër kriminalitetit.

Neni 3

Bashkëpunimi dypalësh në luftën kundër kriminalitetit, në veçanti atij të organizuar dhe të trafikeve të paligjshme në interes të dy vendeve, do të zhvillohet në mënyrë sistematike nga zyra ndërlidhëse italiane interforcë e krijuar në Shqipëri dhe nga oficeri (ose oficerët) shqiptar (ë) i (të) kontaktit i (të) vendosur në Itali.

Neni 4

Zyra ndërlidhëse italiane interforcë në Shqipëri dhe oficeri (ose oficerët) shqiptar (ë) i (të) kontaktit në Itali do të sigurojnë deri më 31 dhjetor 2003, duke rezervuar të drejtën për ripërtëritje të mundshme, rakordimin e nevojshëm informativ dhe hetues me strukturat e policisë së vendit pritës, rakordim që është i destinuar të rrisë më tej bashkëpunimin midis dy vendeve në luftën kundër kriminalitetit.

Veprimi i tyre përshtatet me linjat programatike të përcaktuara në Marrëveshjen bilaterale, si dhe në protokollin shtesë të 24 gushtit 1991 dhe mban parasysh rezultatet e bashkëpunimit në bazë të protokolleve të mirëkuptimit të nënshkruara nga Palët në vitet e mëparshme.

Zyra ndërlidhëse italiane interforcë në Shqipëri zhvillon gjithashtu rakordimin me Qendrën Ndërkombëtare Antitrafik të Vlorës nëpërmjet pjesëmarrjes së përfaqësuesve të saj në veprimtarinë e këtij organizmi.

Për problemet që lidhen me statusin, privilegjet dhe imunitetet e personelit të zyrës ndërlidhëse italiane interforcë, si dhe të mirave materiale e pronave të tij, kohëzgjatjen e përdorimit dhe konditat e shërbimit, lehtësirat valutore dhe të komunikimeve, reklamimet, procedimeve ligjore, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe të çdo problemi tjetër që lidhet me praninë dhe veprimtarinë e zyrës në Shqipëri, do të zbatohet mutatis mutandis, siç parashikohet në "Memorandum of Understanding on the status of the EC Police Assistance (ECPA) project in Albania" ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, nënshkruar në Tiranë, më datë 6 mars 2002.

I njëjti trajtim do të zbatohet edhe ndaj njësive detare dhe ajrore të forcave të policisë italiane dhe personelit përkatës, si dhe specialistëve të tyre, që do të angazhohen herë pas here, në veprimtarinë e mbështetjes, këshillimit, trajnimit dhe asistencës për policinë shqiptare.

I njëjti regjim parashikohet për oficerin (ët) shqiptar (ë) të kontaktit (i) të pranishëm në territorin italian.

Për aspektet e tjera të garancive në favor të përfaqësuesve të forcave të policisë italiane mbeten në fuqi, gjithashtu, dispozitat e parashikuara në protokollin e mëparshëm të mirëkuptimit.

Zyra ndërlidhëse italiane interforcë vazhdon të kryejë koordinimin e veprimtarisë bazuar në nenet 1 dhe 2 të këtij protokollin me qëllim luftën kundër kriminalitetit dhe trafikeve të paligjshme.

Neni 5

Zyra ndërlidhëse italiane interforcë në Shqipëri dhe oficeri (ose oficerët) shqiptar(ë) i (të) kontaktit në Itali bashkëpunojnë, përkatësisht, me Drejtorinë Qendrore të Policisë Kriminale pranë Ministrisë Shqiptare të Rendit Publik dhe me Drejtorinë Qendrore homologe të Ministrisë së Brendshme Italiane-Departamenti i Sigurisë Publike.

Atyre u janë ngarkuar detyrat që vijojnë:

- mbledhja dhe analiza e informacioneve mbi ecurinë e kriminalitetit, mbi organizatat dhe subjektet kriminale, si dhe mbi trafiket e paligjshme, në interes të përbashkët, të dy vendeve;
- thellimin e informacioneve në fushën e hetimeve specifike;
- zbulimin e personave në kërkim;
- asistencë policore në planin teknik dhe shkencor;
- lehtësimin e veprimtarisë së autoriteteve gjyqësore kombëtare pranë autoriteteve kompetente të vendit pritës;
- studimin e linjave të politikës kriminale që synojnë shmangien e vështirësive operative që rrjedhin nga ndryshimet e sistemeve ligjore të të dy vendeve.

Neni 6

Palët, duke garantuar shkëmbimin reciprok të informacioneve në fushën e kriminalitetit dhe të trafikeve të paligjshme nëpërmjet strukturave ndërlidhëse të parashikuara nga ky protokoll, angazhohen, të mos i komunikojnë vendeve të treta, informacionet e marra nga zyra ose oficerët ndërlidhës, pa pëlqimin e vendit që i ka dhënë ato.

Neni 7

Secila Palë Kontraktuese merr përsipër financimin e zyrave të saj dhe administrimin e personelit.

Neni 8

Ky protokoll do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet me shkrim, me anë të të cilave Palët Kontraktuese do t'i komunikojnë njëra-tjetrës përmbushjen e plotë të procedurave përkatëse të brendshme.

Me besimin që të nënshkruarit, posaçërisht të autorizuar, nënshkruajnë këtë protokoll.

Bërë në Lece, më 13.11.2002 në dy tekste origjinale, që të dy të barasvlefshëm, në gjuhët shqipe dhe italiane.

L I G J

Nr.9020, datë 6.3.2003

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN PËR ETIKETIMIN E EKSPLOZIVËVE PLASTIKË PËR QËLLIME ZBULIMI”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për etiketimin e eksplozivëve plastikë për qëllime zbulimi”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3758, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

KONVENTA

MBI ETIKETIMIN E EKSPLOZIVËVE PLASTIKË PËR QËLLIM ZBULIMI

Shtetet Palë të kësaj Konvente:

të vetëdijshëm për ndërhyrjet në sigurinë ndërkombëtare nga aktet terroriste;
duke shprehur shqetësim të thellë ndaj akteve terroriste që synojnë shkatërrimin e avionit,
mjeteve të tjera të transportit apo çfarëdo objektivi tjetër;

të shqetësuar, që për akte të tilla terroriste janë përdorur eksplozivë plastikë;
duke njohur se etiketimi i këtyre eksplozivëve për qëllim zbulimi do të kontribuojë në mënyrë
të ndjeshme në parandalimin e këtyre akteve të paligjshme, ekziston një nevojë urgjente për një
instrument ndërkombëtar, që t’i obligojë shtetet për të adaptuar masat e duhura për t’u siguruar që
eksplozivët plastikë janë etiketuar siç duhet;

duke marrë në konsideratë Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nr.635
të 14 qershorit 1989 dhe Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nr.44/29 të
4 dhjetorit 1989 si një detyrim për Organizatën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar, që të intensifikojë
punën e saj drejt krijimit të një regjimi ndërkombëtar për etiketimin e eksplozivëve plastikë ose
eksplozivë të lehtë për qëllim zbulimi;

duke pasur parasysh Rezolutën A 27-8 adaptuar unanimisht në sesionin e 27 të Asamblesë së
Organizatës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar, e vlerëson me shumë prioritet përgatitjen e një
instrumenti të ri ndërkombëtar në lidhje me etiketimin e lëndëve eksplozive plastike ose eksplozivë
të lehtë për qëllim zbulimi;

duke vërejtur me kënaqësi rolin, që ka luajtur Këshilli i Organizatës së Aviacionit Civil
Ndërkombëtar në përgatitjen e Konventës, si dhe gatishmërinë e tij për të marrë përsipër funksionet në
lidhje me zbatimin e saj,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. “Eksploziv” nënkupton produkte eksplozivi, thjesht të njohur si “eksploziv plastik” duke
përfshirë eksplozivët në formën e fletëve fleksibile ose elastike, siç përshkruhet në aneksin teknik të
kësaj Konvente.

2. “Agjent zbulues” nënkupton, një substancë, siç përshkruhet në aneksin teknik të kësaj
Konvente, e cila është futur brenda në një eksploziv për ta bërë atë të zbulueshëm.

3. “Etiketimi” do të thotë futja në një eksploziv e një agjenti zbulimi në përputhje me aneksin
teknik të kësaj Konvente.

4. “Prodhim” nënkupton, çdo proces, duke përfshirë edhe riprocesin, që prodhon eksplozivë.

5. “Mjetet ushtarake plotësisht të autorizuar” përfshin, por nuk kufizohen tek fishekët,
bombat, predhat, minat, gjylet, raketat, predhat shpërthyes, granatat dhe predhat shpuese të prodhuara
ekskluzivisht për qëllime ushtarake ose policore në përputhje me ligjet dhe rregulloret e shteteve Palë
në lidhje me to.

6. “Shtetet prodhuese” nënkupton, çdo shtet në territorin e të cilit janë prodhuar eksplozivët.

Neni 2

Çdo Shtet Palë do të marrë masat e nevojshme dhe efektive për të ndaluar dhe parandaluar prodhimin në territorin e tij të eksplozivëve të paetiketuar.

Neni 3

1. Çdo Shtet Palë, do të marrë masa të nevojshme dhe efektive për të ndaluar dhe parandaluar lëvizjen për në ose jashtë nga territori i tij të eksplozivëve të paetiketuar.

2. Paragrafi i mësipërm nuk do të zbatohet për lëvizjet për qëllime jo në përputhje me objektivat e kësaj Konvente, prej autoriteteve të një Shteti Palë, që janë duke kryer funksione ushtarake ose policore të eksplozivëve të paetiketuar, nën kontrollin e këtij Shteti Palë në përputhje me paragrafin 1 të nenit 4.

Neni 4

1. Çdo Shtet Palë do të marrë masat e nevojshme për të ushtruar një kontroll të rreptë dhe efektiv mbi posedimin dhe transferimin e posedimit të eksplozivëve të paetiketuar, të cilët kanë qenë prodhuar brenda ose sjellë në territorin e tij, para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në lidhje me këtë shtet, në mënyrë që të parandalohet largimi i tyre ose përdorimi për qëllime, që nuk janë në përputhje me objektivat e kësaj Konvente.

2. Çdo Shtet Palë do të marrë masa të nevojshme për të siguruar që të gjitha stoqet e këtyre eksplozivëve duke iu referuar paragrafit 1 të këtij neni, që nuk mbahen prej autoriteteve të saj, që kryejnë funksione ushtarake ose policore janë shkatërruar ose përdorur për qëllime, që nuk janë në përputhje me objektivat e kësaj Konvente, etiketuar ose të bëra joefektive në mënyrë të përhershme, brenda një periudhe prej 3 (tre) vjetësh nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente në lidhje me këtë shtet.

3. Çdo Shtet Palë do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që i gjithë stocku i këtyre eksplozivëve referuar paragrafit 1 të këtij neni, që mbahet prej autoriteteve të tij, që kryejnë funksione ushtarake ose policore dhe që nuk janë përfshirë si një pjesë përbërëse e mjeteve ushtarake të autorizuar, janë shkatërruar ose përdorur për qëllime, që nuk janë në përputhje me objektivat e kësaj Konvente, etiketuar ose të bëra joefektive në mënyrë të përhershme, brenda një periudhe prej 15 vjetësh nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente në lidhje me këtë shtet.

4. Çdo Shtet Palë do të marrë masat e nevojshme për të siguruar shkatërrimin, sa më shpejt që të jetë e mundur, në territorin e tij, të eksplozivëve të paetiketuar, të cilët mund të zbulohen atje dhe të cilët nuk i janë referuar paragrafëve të mësipërm të këtij neni, përveç stoqeve të eksplozivëve të paetiketuar të mbajtur prej autoriteteve të tij, që kryejnë funksione ushtarake ose policore dhe të përfshira si një pjesë përbërëse e mjeteve ushtarake të autorizuar, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në lidhje me këtë shtet.

5. Çdo Shtet Palë do të marrë masat e nevojshme për të ushtruar kontroll të rreptë dhe efektiv mbi posedimin dhe transferimin e posedimit të eksplozivit, referuar paragrafit II të pjesës 1 të aneksit teknik të kësaj Konvente, në mënyrë që të parandalohet largimin e tyre ose përdorimin për qëllime, që nuk përputhen me objektivat e kësaj Konvente.

6. Çdo Shtet Palë do të marrë masat e nevojshme për të siguruar shkatërrimin, sa më shpejt që të jetë e mundur, në territorin e tij, të eksplozivëve të paetiketuar të prodhuar që nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente në lidhje me atë shtet, që nuk janë përfshirë siç specifikohet në paragrafin II d) të pjesës 1 të aneksit teknik të kësaj Konvente dhe për eksplozivët e paetiketuar, të cilët nuk përfshihen tashmë brenda qëllimit të çdo nënparagrafi të paragrafit II në fjalë.

Neni 5

1. Nga kjo Konventë është krijuar një Komision Teknik Ndërkombëtar për eksplozivët (këtej e tutje i referuar “Komisioni”) i përbërë nga jo më pak se pesëmbëdhjetë dhe jo më shumë se nëntëmbëdhjetë anëtarë të emëruar prej Këshillit të Organizatës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar (këtej e tutje i referuar “Këshilli”), të zgjedhur ndërmjet personave të caktuar prej Shteteve Palë të kësaj Konvente.

2. Anëtarët e Komisionit, do të jenë ekspertë, që kanë një përvojë të drejtpërdrejtë dhe të konsiderueshme në çështjet, që janë të lidhura me prodhimin, zbulimin ose kërkimin e eksplozivëve.

3. Anëtarët e Komisionit do të shërbejnë për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh dhe do t'u jepet e drejta për t'u riemëruar.

4. Sesionet e Komisionit, do të thirren të paktën një herë në vit në selinë e Organizatës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar ose në vende dhe kohë të tilla siç mund të përcaktohet direkt ose të miratohet prej Këshillit.

5. Komisioni do të përcaktojë rregullat e tij të procedurës, të cilat do të jenë subjekt i miratimit nga Këshilli.

Neni 6

1. Komisioni, do të vlerësojë zhvillimet teknike në lidhje me prodhimin, etiketimin dhe zbulimin e eksplozivëve.

2. Komisioni, nëpërmjet Këshillit, do të raportojë punën e tij tek Shtetet Palë dhe organizatat ndërkombëtare të interesuara.

3. Kurdoherë që të jetë e nevojshme, Komisioni do të bëjë rekomandime tek Këshilli për amendamente të aneksit teknik të kësaj Konvente. Komisioni do të përpiqet për t'i marrë vendimet e saj për rekomandime të tilla me konsensus. Në mungesë të konsensusit Komisioni do të marrë vendime të tilla nga një shumicë prej dy të tretave të votave të anëtarëve të saj.

4. Këshilli mundet që, me rekomandimin e Komisionit, t'u propozojë Shteteve Palë, amendamente të aneksit teknik të kësaj Konvente.

Neni 7

1. Çdo Shtet Palë mund që, brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e lajmërimit të një amendamenti të propozuar të aneksit teknik të kësaj Konvente, t'i transmetojë Këshillit komentet e tij. Këshilli do t'i komunikojë këto komente sa më shpejt që të jetë e mundur tek Komisioni për të marrë mendimin e tij. Këshilli do të ftojë çdo Shtet Palë për komentet ose objeksionet që ka për t'u konsultuar me Komisionin.

2. Komisioni do t'i marrë në konsideratë pikëpamjet e Shteteve Palë bërë në përputhje me paragrafin e mësipërm dhe do t'i raportojë ato te Këshilli. Këshilli, pasi të marrë në konsideratë raportin e Komisionit dhe duke marrë parasysh natyrën e amendamentit dhe komentet e Shteteve Palë, duke përfshirë Shtetet prodhuese, mund ta propozojë amendamentin tek të gjitha Shtetet Palë për t'u adaptuar.

3. Në qoftë se një amendament i propozuar nuk do të jetë kundërshtuar nga pesë ose më shumë Shtete Palë me anë të një njoftimi me shkrim te Këshilli brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e njoftimit të amendamentit prej Këshillit, do të gjykohet se është miratuar dhe do të hyjë në fuqi njëqind e tetëdhjetë ditë pas kësaj periudhe ose pas një periudhe tjetër të tillë siç specifikohet në amendamentin e propozuar për Shtetet Palë, që nuk kanë shprehur kundërshtim për këtë.

4. Shtetet Palë, që kanë shprehur kundërshtimin për amendamentin e propozuar mund, më vonë, me anë të depozitimit të një instrumenti të pranimi ose miratimit, të shprehin konsensusin e tyre për të qenë të obliguar prej parashikimeve të amendamentit. 5. Në qoftë se pesë ose më shumë Shtete Palë e kanë kundërshtuar amendamentin e propozuar, Këshilli do ta referojë atë tek Komisioni për konsiderime të mëtejshme.

6. Në qoftë se amendamenti i propozuar nuk ka qenë adaptuar në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, Këshilli mund të thërrasë një konferencë për të gjitha Shtetet Palë.

Neni 8

Në qoftë se është e mundur, Shtetet Palë do t'i transmetojnë Këshillit një informacion, që do ta ndihmonte Komisionin në kryerjen e funksioneve të tij sipas paragrafit 1 të nenit 6.

2. Shtetet Palë do ta mbajnë Këshillin të informuar për masat, që ata kanë marrë për të zbatuar parashikimet e kësaj Konvente. Këshilli do ta komunikojë një informacion të tillë te të gjitha Shtetet Palë dhe organizatat ndërkombëtare të interesuara.

Neni 9

Këshilli, në bashkëpunim me Shtetet Palë dhe organizatat ndërkombëtare të interesuara, do të marrë masat e duhura për të lehtësuar zbatimin e kësaj Konvente, duke përfshirë klauzolën e asistencës teknike dhe masat për shkëmbimin e informacionit në lidhje me zhvillimet teknike në etiketimin dhe zbulimin e eksplozivëve.

Neni 10

Aneksi teknik i kësaj Konvente do të jetë pjesë përbërëse e kësaj Konvente.

Neni 11

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Shteteve Palë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, e cila nuk mund të zgjidhet me anë të negociimeve, me kërkesën e njërit prej tyre do të dorëzohet në arbitrazh. Në qoftë se brenda gjashtë muajve nga data e kërkesës për arbitrazh, Palët nuk janë në gjendje për të rënë dakord mbi organizimin e arbitrazhit, çdo njëra prej këtyre Palëve mund t'ia referojnë mosmarrëveshjen, me anë të një kërkesë, Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në përputhje me Statutin e Gjykatës.

2. Çdo Shtet Palë mundet që, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimi ose miratimit të kësaj Konvente ose të hyrjes në të, të deklarojë që ajo nuk e konsideron veten të lidhur prej paragrafit të mësipërm. Shtetet e tjera Palë nuk do të jenë të lidhura prej paragrafit të mësipërm në lidhje me çdo Shtet Palë, që ka bërë një rezervim të tillë.

3. Çdo Shtet Palë, që ka bërë një rezervim të tillë në përputhje me paragrafin e mësipërm mund, në çdo kohë, ta tërheqë këtë rezervim me anë të njoftimit tek depozituesi.

Neni 12

Përveçse siç përcaktohet në nenin 11, asnjë rezervim nuk mund të bëhet tek kjo Konventë.

Neni 13

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim në Montreal më 1 mars 1991 prej shteteve pjesëmarrëse në Konferencën Ndërkombëtare mbi Ligjet, e Ajrit mbajtur në Montreal nga data 12 shkurt deri në 1 mars 1991. Pas 1 marsit 1991, Konventa do të jetë e hapur tek të gjitha shtetet për nënshkrim në selinë e Organizatës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar në Montreal deri sa ajo të hyjë në fuqi në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni. Çdo shtet, i cili nuk e nënshkruan këtë Konventë, mund të hyjë në të në çdo kohë.

2. Kjo Konventë do të jetë subjekt i ratifikimit, pranimi, miratimit ose hyrjes prej shteteve. Instrumentet e ratifikimit, pranimi, miratimit ose hyrjes do të depozitohen në Organizatën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar, e cila është përcaktuar si depozituese. Kur të depozitojnë instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimi, miratimit ose hyrjes, çdo shtet do të deklarojë nëse është apo jo një shtet prodhues.

3. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës së depozitimit të tridhjetë e pestë të instrumenteve të ratifikimit, pranimi, miratimit ose hyrjes tek depozituesi, me kusht që jo më pak se pesë shtete të tilla të deklarojnë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, që ato janë shtete prodhuese. Me depozitimin e tridhjetë e pesë instrumenteve të tilla para depozitimit të instrumenteve të tyre prej pesë shteteve prodhuese, kjo Konvente do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi, miratimit ose hyrjes të pesë shteteve prodhuese.

4. Për shtetet e tjera, kjo Konventë do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës së depozitimit të instrumenteve të tyre të ratifikimit, pranimi, miratimit ose hyrjes.

5. Sapo Konventa të hyjë në fuqi, ajo do të regjistrohet prej depozituesit në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe në përputhje me nenin 83 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar (Chikago, 1944).

Neni 14

Depozituesi do të njoftojë menjëherë nënshkruesit dhe Shtetet Palë për:

1. çdo nënshkrim të kësaj Konvente dhe datën e saj;
2. çdo depozitim të një instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose hyrjes dhe datën e saj, duke dhënë një referencë të veçantë nëse Shteti e ka identifikuar vetveten si një shtet prodhues;
3. datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente;
4. datën e hyrjes në fuqi të çdo amendamenti të kësaj Konvente ose aneksin teknik të saj;
5. çdo denoncim bërë sipas nenit 15;
6. çdo deklaram të bërë sipas paragrafit 2 të nenit 11.

Neni 15

1. Çdo Shtet Palë mund të denoncojë këtë Konventë me anë të një lajmërimi me shkrim tek depozituesi.

2. Denoncimi do të ketë efekt 180 ditë pas datës së marrjes të lajmërimit nga depozituesi.

Në cilësinë e dëshmitarit të plotfuqishmit nënshkrues, duke qenë të autorizuar për këtë nga qeveritë e tyre, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Montreal, më 1 mars të vitit 1991, një origjinal, hartuar në 5 tekste autentike në gjuhët anglisht, frëngjisht, rusisht, spanjisht dhe arabisht.

Aneksi teknik

Pjesa 1: Përshkrimi i eksplozivëve

1. Eksplozivët, duke iu referuar paragrafit 1 të neni 1 të kësaj Konvente, janë ato që:

a) janë formuar me një ose më tepër eksplozivë të lartë, të cilët në formën e tyre të pastër kanë një presion avullimi më pak se 10-4 pa në një temperaturë prej 250 C;

b) janë formuar me një material lidhës;

c) janë, si një përzierje e farkëtueshme ose fleksibile në një temperaturë normale dhome.

2. Eksplozivët e mëposhtëm, megjithëse plotësojnë përshkrimin e eksplozivëve në paragrafin 1 të kësaj pjese, nuk do të konsiderohen eksplozivë për aq kohë sa ata vazhdojnë të mbahen ose përdoren për qëllimet e specifikuar më poshtë ose mbeten të përfshira siç specifikohet atje, kryesisht ato eksplozivë që:

a) janë prodhuar, ose mbajtur në sasira të kufizuara për përdorim në kërkime të autorizuara, në zhvillimin ose testimin e eksplozivëve të rinj ose të modifikuar;

b) janë prodhuar ose mbajtur në sasira të kufizuara vetëm për përdorim në stërvitjet e autorizuara, në zbulimin e eksplozivëve dhe/ose në zhvillimin ose testimin e pajisjeve të zbulimit të eksplozivëve;

c) janë prodhuar ose mbajtur në sasira të kufizuara vetëm për qëllime të autorizuara të mjekësisë ligjore;

d) janë të destinuara të jenë të përfshira si një pjesë përbërëse e mjeteve ushtarake të autorizuara në territorin e shtetit prodhues brenda tre vjetëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në lidhje me këtë shtet. Këto mjete të prodhuara në këtë periudhë të tre vjetëve, duhet të gjykohen si mjete ushtarake të autorizuara plotësisht brenda paragrafit 4 të nenit IV të kësaj Konvente.

3. Në këtë pjesë:

“e autorizuar plotësisht” në paragrafin II a), b) dhe c) nënkupton lejimet në përputhje me ligjet dhe rregullat e Shtetit Palë në lidhje me to;

“eksplozivë të lartë” përfshihen, por nuk janë të kufizuara për ciklotetrametilenetetranitraminet (HMX), pentaeritritole tetranitrate (PETN) dhe ciklotetrametiletrinitamine (RDX).

Pjesa 2: Agjentët e zbulimit

Agjent zbulimi është një nga ato substanca të vendosura në tabelën e mëposhtme. Agjentët e zbulimit të përshkruar në këtë tabelë kanë për qëllim të përdoren për përforsimin e zbulimit të eksplozivëve me anë të mjeteve avulluese të zbulimit. Në çdo rast futja e një agjenti zbulimi në një eksploziv, duhet të bëhet në atë mënyrë për të arritur një shpërndarje homogjene në produktin e përfunduar. Minimumi i koncentrimin të një agjenti të zbulimit në produktin e përfunduar në kohën e

prodhimit duhet të jetë siç është treguar në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi i agjentit të zbulimit	Formula molekulare	Pesha molekulare	Minimumi koncentrim
Etilen glikol dinitrate	C ₂ H ₄ (NO ₃) ₂	152	0.2% të masës
2,3 Dimethyl 2,3-dinitrobutane (DMNB)	C ₆ H ₁₂ (NO ₂) ₂	176	0.1% të masës
Para-Mononitrotoluene (p-MNT)	C ₇ H ₇ NO ₂	137	0.5% të masës
Ortho-Mononitrotoluene (o-MNT)	C ₇ H ₇ NO ₂	137	0.5% të masës

Çdo eksploziv, i cili si rezultat i formulimit normal, përmban ndonjë nga agjentët e zbulimit në ose mbi nivelin e minimumit të koncentrimin të kërkuar duhet të gjykohej se duhet etiketuar.

V E N D I M
Nr.68, datë 20.2.2003

PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT TË DEPUTETËVE

Në mbështetje të neneve 13, 14, 18 dhe 19 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”, ndryshuar me ligjin nr.8988, datë 24.12.2002, me propozimin e një grupi deputetësh të Komisionit të Përhershëm të Mandateve, Imunitetit dhe Rregullores,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Paga e deputetit përcaktohet sipas ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit” neni 13 pika 2. Për çdo mungesë pa arsye në seancat plenare të Kuvendit, deputeti i ndalohej nga paga 4 000 lekë. Mungesë pa arsye për efekt page quhen të gjitha mungesat, përjashtuar rastet kur me miratimin e Kryetarit të Kuvendit, deputeti merr pjesë në veprimtari zyrtare brenda ose jashtë vendit.

Kryetari i Kuvendit përcakton me udhëzim mënyrën e evidentimit të pjesëmarrjes së deputetëve në seancë plenare.

II. Përveç pagës bazë, deputeti shpërblehet për pjesëmarrje në mbledhje të komisionit të përhershëm ku bën pjesë. Në këtë rast, masa e shpërblimit është 2 000 lekë për çdo mbledhje.

Masa e shpërblimit për kryetarët e komisioneve të përhershme të Kuvendit është 2 500 lekë dhe për kryetarët e nënkomisioneve 2 200 lekë për mbledhje.

Kryetari i grupit parlamentar merr 5-15 për qind mbi pagën e deputetit, në raport me numrin e anëtarëve të grupit.

Pjesëmarrja për Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financës e Privatizimit dhe për Komisionin e Përhershëm për Çështjet Kushtetuese e Ligjore të paguhet për 12 mbledhje në muaj, kurse për komisionet e tjera për 8 mbledhje në muaj, ndërsa komisionet e posaçme do të paguheshin sipas vendimit të Kuvendit për krijimin e tyre. Pagesa do të bëhet sipas listëprezencës së pjesëmarrjes të deputetëve në komision.

III. Përfitojnë dietë 12 ditë në muaj deputetët që banojnë jashtë qytetit të Tiranës; 6 ditë në

muaj deputetët që banojnë në qytetin e Tiranës dhe kanë zonën jashtë këtij qyteti, si dhe 6 ditë në muaj të gjithë deputetët e tjerë.

IV. Deputetëve u paguhet për shërbime telefonike 17 000 lekë në muaj, ndërsa kryetarëve të komisioneve të përhershme dhe kryetarëve të dy grupeve parlamentare më të mëdha 20 000 lekë në muaj.

V. Kuvendi merr përsipër pajisjen me makina të deputetëve dhe për lëvizjen e tyre ata marrin vlerën në lekë të karburantit. Çmimet e karburantit përcaktohen mbi bazën e çmimeve të raporteve zyrtare të INSTAT-it dhe mund të korrigjohen në çdo tre muaj.

Sasia e karburantit llogaritet në bazë të metodikës së miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit mbi normat e transportit të deputetëve.

VI. Deputetët marrin vlerën në lekë për shpenzimet e shërbimeve periodike dhe mirëmbajtjen e makinave të Kuvendit, të cilat i kanë në përdorim. Shpenzimet për mirëmbajtjen e makinave llogariten në bazë të metodikës së miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm, sipas tipit të automjetit, gjendjes teknike dhe distancës së zonës elektorale. Për deputetët që përdorin makinë private, kjo pagesë do të jetë e barabartë me mesataren e shpenzimeve të llogaritura për deputetët që përdorin makinat e Kuvendit.

Këto fonde do të përdoren nga vetë deputetët, duke zbatuar të gjitha kërkesat teknike për shërbimet periodike dhe mirëmbajtjen.

Kuvendi nuk përgjigjet për sigurimin e mjeteve private të deputetëve, si dhe nuk mbulon shpenzimet për dëmtimet që vijnë si pasojë e keqpërdorimit të makinës nga përdoruesi.

VII. Kuvendi mbulon shpenzimet për strehimin e deputetëve në hotelin e caktuar për këtë qëllim ose paguan kundrejt një kontrate qiraje të rregullt, shpenzimet për strehimin e tyre në apartamente banimi private, me kusht që ky shpenzim të jetë jo më shumë se 45 000 (dyzet e pesë mijë) lekë në muaj.

VIII. Pagesat e llogaritura sipas pikave III, IV dhe V u jepen cash në dorë deputetëve në datën 10 të çdo muaji. Pagesa e llogaritur sipas pikës VI jepet në të njëjtën mënyrë çdo tre muaj. Për pikën VII pagesa bëhet në datën 10 të çdo muaji, sipas kontratave të paraqitura.

IX. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë në datën 1.3.2003.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Servet Pëllumbi

V E N D I M

Nr.70, datë 10.3.2003

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR SHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË PËRDORIMIT TË FONDEVE PUBLIKE DHE TË ARDHURAVE TË TJERA NË MINISTRINË E KULTURËS DHE BASHKINË E TIRANËS PËR PERIU DHËN 1992-2002, SI DHE ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË PËR ZHVILLIMIN URBANISTIK NË TIRANË PËR PERIU DHËN 1992-2002

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Ngrihet komisioni hetimor i Kuvendit:

a) për të shqyrtuar ligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike dhe të ardhurave të tjera në Ministrinë e Kulturës dhe Bashkinë e Tiranës për periudhën 1992-2002;

b) për të shqyrtuar zbatimin e ligjshmërisë në zhvillimin urbanistik për qytetin e Tiranës për

periudhën 1992-2002.

II. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 anëtarë nga pozita dhe 5 anëtarë nga opozita.

III. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej 3 muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

IV. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.71, datë 13.3.2003

**PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT, NGRITUR
ME VENDIMIN E KUVENDIT NR.70, DATË 10.3.2003**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të vendimit të Kuvendit nr.70, datë 10.3.2003

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Përbërja e Komisionit hetimor të Kuvendit, ngritur me vendimin nr.70, datë 10.3.2003 "Për ngritjen e Komisionit hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e ligjshmërisë së përdorimit të fondeve publike dhe të të ardhurave të tjera në Ministrinë e Kulturës dhe Bashkinë e Tiranës për periudhën 1992-2002, si dhe zbatimin e ligjshmërisë për zhvillimin urbanistik në Tiranë për periudhën 1992-2002" është si më poshtë:

1. Sokol Olldashi	PD	Kryetar
2. Bardhyl Agasi	PS	Nënkryetar
3. Musa Ulqini	PS	Anëtar
4. Fatmir Xhafa	PS	"
5. Erion Braçe	PS	"
6. Ndre Legisi	PS	"
7. Lekë Çukaj	PS	"
8. Ilir Bano	PD	"
9. Nard Ndoka	PDr	"
10. Sali Shehu	PLL	"
11. Uran Metko BK	"	"

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.72, datë 17.3.2003

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E
VEPRIMTARISË SË QEVERISË PËR TRANSPARENCËN E PROCESIT TË FIRMAVE
PIRAMIDALE NË BAZË TË LIGJIT NR.8215, DATË 9.5.1997 "PËR KONTROLLIN
FINANCIAR TË PERSONAVE JURIDIKË JOBANKARË QË KANË MARRË HUA NGA
PUBLIKU I GJERË"**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të nenit 164 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Ngrihet komisioni hetimor i Kuvendit për të shqyrtuar:

1.Procesin e transparencës së firmave piramidale, evidentimin e aseteve të tyre, si dhe mënyrën e shitjes së këtyre aseteve, evidentimin e masës dhe mënyrës së shlyerjes së kreditorëve, për të verifikuar zbatimin nga Qeveria dhe Grupi Mbikëqyrës të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", si dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore lidhur me këtë proces.

2.Implikimin e politikanëve dhe zyrtarëve të lartë me firmat piramidale.

II. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, prej të cilëve 6 anëtarë nga grupet parlamentare të pozitës dhe 5 anëtarë nga grupet parlamentare të opozitës.

III. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej 3 muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

IV. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit për të marrë të gjitha masat administrative të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.73, datë 20.3.2003

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.37, DATË 16.5.2002 "PËR
KRIJIMIN E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PAKTIT TË
STABILITETIT", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 22, 30 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Deputeti Besnik Mustafaj caktohet anëtar i Komisionit të Integrimit European dhe Paktit të Stabilitetit në vendin vakant të krijuar nga largimi i deputetit Lublin Dilja.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Servet Pëllumbi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbardimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 27.3.2003

Doli nga shtypi më 28.3.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë